



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E OBILICIT-OPŠTINA OBILIĆ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS FËRQËTRORIT
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE

Dalës-Izleznik

Nr. 1798
Br. 1798
OBILIĆ-OBILIĆ

Data 18.07.2022
Datum



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq-Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.27.06.2022, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin: Vlora Mjekiqi Kabashi, Enver Gashi, Labinot Mirena, Sami Ahmeti, Nazlije Shala dhe Bajram Hashani

Të pranishmit tjerë: drejtorët komunal dhe përf.e KFOR-it

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Planifikimi i buxhetit për vitin 2023 dhe parashikimet për vitet 2024 dhe 2025
4. Shqyrtimi i kërkesës për dhënien në debat publik të Draft Rregulloren për tarifa, ngarkesa dhe gjopa komunale në Komunën e Obiliqit
5. Shqyrtimi i Rregullores për organizimin, riorganizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale të Obiliqit
6. Shqyrtimi i kërkesës për formimin e Komisionit për përzgjedhjen e Këshillave lokale
7. Shqyrtimi i kërkesave
8. Të ndryshme

Kryesuesja – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miraua me 6 vota për.

Pika 1 e rendit të ditës

Mungoi: Ajshe Haliti Pllana me arsye.

Pika 2 e rendit të ditës

Sami Ahmeti – Në lidhje me procesverbalin e mbledhjes së fundit të KPF-së, ju e dini se ka ndodhë një problem teknik, ta themi edhe pse mu dukë i qëllimshëm. Procesverbali na ka ardhë shabllon çka iu ka kujtue zyrtares me shkruar pa fajin e saj. Unë besoj se më mirë ka qenë me shkruar që për shkak të çështjeve teknike nuk kemi material se sa të shkruhet psh në emrin tim që unë kam thënë te posta, që është dakord me u dislokue posta. Unë nuk jam dakord me këtë procesverbal, kërkoj mirëkuptim për këtë dhe kuptoj se ndodhin problemet teknike, edhe pse zyrtari mua më tha në telefon se kam qenë nervoz dhe nuk e kam inçizue mbledhjen dhe ajo a është arsye apo nuk është nuk është problem. Unë propozoj që të shkruhet në procesverbal se nuk kemi material për shkak të çështjeve teknike, se sa të shkruhet diçka që nuk kemi thënë.

Kryesuesja - Vërtetë, ka pasë probleme teknike dhe nëse, pajtoheni që propozimi i z.SamiAhmeti, me qëndrue të paktën aty, ku nuk jemi të sigurtë me thënë se për shkak të gabimit teknik nuk ka material.

Enver Gashi – Mendoj se më mirë është me shkruar diçka se hiç sepse sekretaria e Kuvendit, sigurisht se diçka e kapë nga Kuvendi dhe me kalue mbledhja pa asnjë shenim ndoshta, është edhe më keq, ose fundi i fundit më mirë është me përsëritë se me lënë blanko.

Kryesuesja – Ne menduam te pjesa ku ka folë z.Ahmeti, ka të drejtë me kërkue nëse, nuk është ajo çfarë ka thënë me heqë fjalimin e tij, ndërsa të tjerat mbeten sepse nuk kanë ndonjë vërejtje. Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 5 vota për me vërejtjet e cekura më lartë.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet planifikimin e buxhetit për vitin 2023 dhe parashikimet për vitet 2024 dhe 2025.

Enver Gashi – Meqë, është bërë debati dhe njoftimi zyrtar dhe planifikimi i buxhetit afatmesëm është gjithë i rregulltë. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se do të mbetet ky buxhet sepse ka rishikime dhe mundësi të ndryshimeve. Mendoj se të gjitha punët rreth kësaj teme janë kryer dhe ne jemi për që të kaloj.

Sami Ahmeti – Edhe ne jemi dakord që ky planifikim të shkoj në mbledhjen e radhës të Kuvendit komunal. Ne kishim pasë dëshirë te investimet kapitale, ku është cekë psh ndërtimi i sheshit të emërohen disa gjëra, të dihet se ku parashihen këto. Ndërtimi i sheshit dhe plot gjëra tjera, duhet të jenë të specifikuara, sikur që janë psh ndërtimi i katit të dytë të QKMF-së, do të thotë të dijmë saktë ndërtimi i sheshit se cili është ai dhe ku është ai. Përndryshe, unë mund ti bëjë kërkesë Drejtorisë që deri në ditën kur mbahet seanca të dijnë anëtarët e Kuvendit komunal se ku planifikohen ato. Përndryshe, jemi për që të bisedohet ky planifikim buxhetor në seancën e ardhshme.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komiteti për Politikë dhe Financa me 6 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal shqyrtimin dhe aprovimin e Planifikimit të buxhetit për vitin 2023 dhe parashikimet për vitet 2024 dhe 2025.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet për shqyrtim kërkesën e DKA-së, për dhënien në debat publik të Draft Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale në Komunën e Obiliqit.

Sami Ahmeti – Ne jemi dakord që ta rekomandojmë këtë Draft Rregullore për debat publik, por kishim pasë dëshirë që ti ketë disa ndryshime në raport me debatet publike. Debatet publike, ne e dijmë se edhe kur mbajmë takime partiake, apo diçka të tillë në këtë kohë vere është problem qytetarët që të grumbullohen sepse i kanë hallet dhe problemet e veta. Ne shpesh marrim email-a, për takime të ndryshme që kanë dërguar organizatat të parëndësishme për çështjen e profitit të tyre, ju veç bëni forward dhe krejtë është në rregullë. Mendoj se do të ishte mirë që kur të bëhen debatet publike të na dërgoni edhe neve, një email, në mënyrë që edhe ne ti thërrasim qytetarët që i kemi mbështetës tonë, të bëhet më interesante dhe të bëhet një planifikim i duhur sepse kështu qysh po bëhen debatet publike kam përshtypjen se po bëhen vetëm me zyrtarë komunal.

Kryesuesja – Njoftimi është publik dhe shihet në faqen zyrtare të Komunës, por nuk na kushton asgjë të ju njoftojmë edhe me email, që të merrni pjesë kur është debati publik.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 6 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal dhënien në Debat publik të Draft Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale në Komunën e Obiliqit.

Pika 5 e rendit të ditës –

Kryesuesja – Paraqet shqyrtimin e Rregullores për organizimin, riorganizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale të Obiliqit sipas kërkesës së administratës që kjo Rregullore të rekomandohet për shqyrtim dhe aprovim në Kuvendin komunal.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që kjo Rregullore ti rekomandohet Kuvendit, të debatohet dhe ti japë vizën.

Sami Ahmeti – Ne kemi shumë vërejtje në këtë Draft Rregullore, megjithatë jemi për që të bisedohet në seancë dhe aty do ti japim vlerësimet tona.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 6 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal shqyrtimin dhe aprovimin e Rregullores për organizimin, riorganizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale të Obiliqit.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet kërkesën për formimin e Komisionit për përzgjedhjen e Këshillave lokale.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që edhe kjo pikë të shkoj në Kuvend, të debatohet dhe aty të propozohen anëtarët e Komisionit nga pozita, opozita, OJQ-ja dhe përfaqësuesi i komunitetit ku mbahet përzgjedhja e Këshillave lokale.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 6 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal për shqyrtim dhe aprovim kërkesën për formimin e Komisionit për përzgjedhjen e Këshillave lokale.

Pika 7 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet peticionin për ndalimin e betonjerkës në lagjen “Aliu” në Milloshevë rr:”Martirët Aliu” . Mendoj se ky peticion duhet ti adresohet Drejtorisë së inspeksionit, Drejtorisë së urbanizmit dhe Drejtorisë së ambientit, të cilët obligohen që në mbledhjen e Kuvendit të vijnë me raport dhe sqarime shtesë lidhur me këtë betonjerkë, nëse pajtoheni edhe ju.

Enver Gashi – Ne pajtohem.

Sami Ahmeti – Pikërisht këto janë pyetjet që unë i kam drejtuar te Drejtoritë, që të na tregojnë se ku janë me dokumente, a ka ndodhë ai fillim i asaj betonjerke pa vetëdijen e Komunës, apo është bërë e qëllimshme. Unë jam shumë dakord me atë që ju e propozuat, që në seancën e ardhshme të kemi raport prej këtyre 3 Drejtorive, ose edhe më shumë nëse janë të involvuar.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 6 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal shqyrtimin e Peticionit për ndalimin e ndërtimit të betonjerkës në lagjen “Aliu” në Milloshevë rr:”Martirët Aliu” dhe 3 Drejtoritë përkatëse, të vijnë me sqarime në seancën e Kuvendit komunal.

Kryesuesja – Paraqet kërkesën nga Habib Gajtani për vendosjen e një kontejneri. Propozoj që kjo kërkesë ti adresohet Drejtorisë së urbanizmit, që nëse ka marrëveshje siç po potencohet me sjellë atë marrëveshje dhe dokumente shtesë, të dijme se çka është në pyetje me këtë kërkesë të valës.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 6 vota për ia rekomanduan DPUKP-së, për shqyrtim kërkesën e Habib Gajtani për vendosjen e pajisjeve të Telekomit në një kontejner afër Shtëpisë së Kulturës dhe në seancën e Kuvendit, Drejtoria në fjalë të vjen me një rekomandim.

Kryesuesja – Paraqet kërkesën nga Fadil Curri, për sistemim në vendin e punës në bibliotekën e qytetit, apo në bibliotekën e SHFMU Dr.”Ibrahim Rugova” në fshatin Mazgit i Ulët. Propozoj që kjo kërkesë ti drejtohet Drejtorisë së Arsimit dhe Ministrisë së Arsimit, nëse ata e shohin të obligueshme që në këto shkolla me pasë biblioteka dhe me hapë konkurs për punëtorë. Ndërsa, Kuvendi nuk ka të bëjë fare me punësimin e njerëzve, apo me konkurse të tilla.

Enver Gashi – Ne jemi marrë vesh fillimisht që çdo kërkesë e cila shkon në Drejtori të caktuar rekomandimet e Drejtorisë, na vijnë neve në Kuvend dhe atëherë ne mund të debatohet.

Kryesuesja – Ju sqaroj se kërkesat që i drejtohen Kuvendit komunal, unë e kam obligim ti paraqes në KPF, pastaj drejtohen në Drejtoritë përkatëse dhe vijnë me sqarim në seancën e radhës.

Sami Ahmeti – Gjithsesi, pajtohem me atë që ju e thatë për faktin se jo gjithmonë qytetarët e dinë se kujt ti drejtohen. Shumë shpesh, e mendojnë dhe është e vërtetë që Kuvendi është organi më i lartë, megjithatë jo për të tilla çështje. Sikur ai të kishte bërë kërkesë për një ndihmë, për një çështje të librit, apo të furnizimit të asaj biblioteke, që unë e vlerësoj shumë sepse ai e bën një punë shumë të madhe në raport me qytetarët dhe të mirën e përgjithshme. Besoj se sikur që ndahen për shumë çështje tjera, do të ishte mirë të ndahet diçka edhe për atë krijues. Megjithatë forma e tillë e kërkesës dhe ai ka menduar se është mirë ti drejtohet Kuvendit, e ju e keni sjellë te ne. Drejtoria duhet të bëjë një rekomandim ose një shkresë lidhur me këtë çështje, që të informoj edhe palën që ka bërë kërkesë, por edhe disa në Kuvend, që ndoshta nuk janë shumë të informuar se kjo shkon me konkurse dhe është shumë normale, që kjo nuk ka mundësi të bëhet përmes Kuvendit.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 6 vota për ia rekomanduan për shqyrtim Drejtorisë së Arsimit komunal kërkesën e Fadil Currit.

Kryesuesja – Paraqet kërkesën nga Binak Prenku, nga fshati Lajthishtë për trajtim të rrugës. Mendoj se edhe kjo kërkesë duhet të shkojë në Drejtorinë e infrastrukturës dhe mundësisht Drejtoria të delë në terren e ta përfshin në listë këtë rrugë për asfaltim.

Sami Ahmeti – Ju po i shpjegoni të gjitha dhe nganjëherë nuk po kemi çka të themi, veç me i përsëritë. Megjithatë, në këtë rast Drejtoria e infrastrukturës është mirë me ardhë me një shkresë, të na tregoj se qysh

e ka planifikimin. Mendoj se ky zotëriu, për të cilin e di se edhe më heret ka bërë kërkesa të tilla, nuk është mirë të anashkalohet kushdo qoftë sepse tash as nuk jemi në fushatë zgjedhore. Unë për vete e konsideroj secilin qytetar të Komunës, pa marrë parasysh në cilin subjekt politik është se kjo është më e vogla që duhet të shikohet dhe të merret parasysh edhe kërkesa e këtij qytetari sepse sigurisht që ka hall.

Enver Gashi – Në bazë të përshkrimit të këtij qytetari të nderuar Prenkut, e vetmja rrugë në fshat, do të thotë Drejtoria e infrastrukturës dhe në përgjithësi Ekzekutivi Lajthishtën e paskan trajtue taman, paska mbetë vetëm një rrugë, atëherë me i shikue mundësite me krye edhe atë dhe me thënë se Lajthishta është komplet me infrastrukturë rrugore

Sami Ahmeti – Unë do të dëshiroja të ishte ashtu. Para pak ditësh, një prej qytetarëve të Lajthishtës, më ka kërkuar a ka mundësi se nuk kam printer me shtyp një kërkesë për me dorëzue në Kuvend dhe aty shkruan afër 7,8 rrugë të Lajthishtës dhe disa që janë shtruar vjet e ishin prishë. Megjithatë, kërkesa ende nuk ka ardhë dhe Binaku, e ka bërë kërkesën vetëm për vete dhe ka ardhë edhe një kërkesë tjetër të cilën nuk e keni sjellë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 6 vota për ia rekomanduan Drejtorisë për infrastrukturë kërkesën e Binak Prenkut, nga fshati Lajthishtë për trajtim të rrugës.

Kryesuesja – Paraqet kërkesën nga Sadik Krasniqi, për ndërtimin e një shtëpie 1 dhomëshe për vendosjen e mjeteve për hapjen dhe mirëmbajtjen e varrezave dhe mjeteve për bartjen e kufomave, si banorë të fshatit Breznicë.

Abdyrrahman Krasniqi – Ne i kemi bërë planifikimet për këtë vit dhe do ta kemi parasysh këtë kërkesë. Në vitin e kaluar është dorëzuar shtëpia për të pame në Breznicë, ndërsa sa i përket kësaj kërkesë ne jemi të njoftuar dhe besoj se shumë shpejtë do të rregullohet kjo çështje.

Sami Ahmeti – Kërkesat bazike të cilat qytetari apo kushdo që i ka dërguar në Kuvend, nuk do të duhej të vinin fare këtu, për faktin se Komuna ka mjete dhe duhet të bëhet një diçka e tillë, besoj shumë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 6 vota për ia rekomanduan DSHPE-së, për shqyrtim dhe aprovim kërkesën nga Sadik Krasniqi, nga fshati Breznicë për ndërtimin e një shtëpie një dhomëshe për vendosjen e mjeteve për hapjen dhe mirëmbajtjen e varrezave dhe mjetet për bartjen e kufomave.

Kryesuesja – Ju njoftoj se është bërë një gabim teknik në vendimin nr.-I-61, të dt.28.04.2022, ashtu që është dashur të ceket se shfuqizohet Rregullorja e vitit 2009 për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës për biznese, përndryshe Rregullorja ka ardhë e ligjshme nga MAPL-ja.

E kemi edhe një kërkesë e cila ka ardhë para seancës së Kuvendit, ku DSHPE-ja, ka kërkuar të procedohet në mbledhjen e Kuvendit, ndryshimin e aksionarëve në kompaninë KRM “Pastrimi”.

Abdyrrahman Krasniqi – Deri më tani kanë qenë aksionarë: Naim Miftari, ish drejtor i DSHPE-së, Hysni Mjeku, ish anëtar i Kuvendit dhe 1 anëtar tjetër, të cilët tash duhet të zëvendësohen sipas ligjeve në fuqi. Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 6 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës nga DSHPE-ja, për ndryshimin e aksionarëve në kompaninë KRM “Pastrimi”.

Pika 8 e rendit të ditës

Labinot Mirena – Unë e kam një vërejtje se dje më ka ardhë një informatë prej banorëve ku unë jetoj te sheshi që është duke i vendosë posta disa antena në minare të xhamisë. Tash, jemi duke e përgatitë një takim me ata banorë dhe duhet të shikojmë me DPUKP-në, se a kanë sjellë ndonjë leje sepse ne jemi kategorik kundër. Mendoj se nuk lejohet të sjellen antenat në vijën ajrore që i ka dikund 20 metra, që janë banorët prej tyre. Edhe nëse, kanë kërkuar ndonjë leje, ne mendojmë se patjetër duhet me ua refuzue.

Kryesuesja - Unë e potencova më heret se është bërë një kërkesë, po flitet për një marrëveshje, është fjala për valën dhe ju materialin e keni marrë. Ne këtë çështje ia rekomanduam DPUKP-së e cila në mbledhjen e Kuvendit, duhet të vjen me sqarim.

Labinot Mirena – Ato antena që presin të vendosen aty, edhe nëse është wifi-a falë janë të dëmshme për banorët dhe nëse, vendosen ato antena, ne jemi kundër sepse aty jetojnë banorët prej 10-15 metrave. Mendoj se mund të gjendet ndonjë lokacion më i përshtatshëm për ata dhe për neve që nuk ka dëm, por

ato lëshojnë rreze prandaj, edhe ne jemi kundër. Unë personalisht jam dhe do të jem kundër derisa të iu refuzohet ajo leje.

Sami Ahmeti - Unë i kam 2 kërkesa dhe kërkesa e parë është që në seancën e ardhshme të diskutohet raporti i auditorit të jashtëm. Gjithashtu, kërkoj që në seancën e ardhshme Drejtoria e Arsimit, të na informoj për mbylljen e vitit shkollor, klasët e 9-ta e kanë kryer këtë cikël të shkollimit, si ka funksionue, a janë mbajtur mbrëmjet e semi maturës. Këtë, e kishim kërkuar të paktën që në seancën e ardhshme me na u arsyetue se si ka shkue çështja.

Kryesuesja – Sa i përket raportit të auditorit të jashtëm deri në ditën që e kemi dorëzuar materialin për KPF, nuk ka qenë publik as nga njësia e auditorit atje në qendër. Ne e kemi futë si pikë në rendin e ditës, por meqë ata nuk e kanë publikue, ne nuk kemi mund me vazhdue. Në seancën e radhës, do të jetë patjetër. Sa i përket Drejtorisë së Arsimit, unë e di se nuk kanë përfundue me përmbyllje të vitit, por do ta adresoj çështjen.

Sami Ahmeti – Të paktën, për klasët e 9-ta, sepse në një shkollë kam vërejtje drastike edhe për klasët e 9-ta, mua më intereson vetëm mbrëmja e semi maturës si ka funksionue, që besoj se këtë shpjegim ka mundësi me marrë mundin Drejtoria e Arsimit.

Kryesuesja – Unë patjetër do ta adresoj kërkesën te Drejtoria dhe besoj se ata do të jenë prezentë dhe do ta shpjegojnë çështjen.

Labiot Mirena - Nëse, bën, nuk e di z.Naim Miftari, në çfarë cilësie po i përgjigjet sepse ky është drejtor i inspeksionit dhe nuk është drejtor i Arsimit. Unë iu kisha lutë të mos përzihet nëse, nuk i përket tema atij.

Kryesuesja – Ai vetëm u mundua me na sqarue, përndryshe jemi në rregullë.

Mbledhja përfundoi në ora 10:38'

Bashk.prof.për punë të KK


Azize Zeneli

